

## **Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi Konferencën e 9-të Ndërkombëtare Shkencore “Sfidat e fundit në Inovacionin e Sipërmarrjes dhe Kornizën Ligjore”**

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” zhvilloi konferencën e 9-të Ndërkombëtare me titull **“Sfidat e fundit në Inovacionin e Sipërmarrjes dhe Kornizën Ligjore”**.

Kjo konferencë bëri bashkë akademikë, kërkues shkencorë, doktorantë dhe studentë duke nxitur debatin shkencor në funksion të përmirësimit të kërkimit, duke mundësuar një gërshetim të kontributit teorik dhe atij praktik në punime tematike të ndjeshme ndaj kërkesave aktuale të shoqërisë.

Dekania e Fakultetit Ekonomik, prof. as. dr. Imelda Sejдини, çeli punimet e kësaj konference dhe në fjalën e saj theksoi se angazhimi i vazhdueshëm në kërkimin shkencor është pjesë e pandashme e punës së fakultetit dhe organizmi i konferencave të përvitshme i jep mundësi si stafit akademik ashtu edhe kërkuesëve të rinj për të diskutuar dhe publikuar punimet e tyre me fokus zhvillimet bashkëkohore.

Konferenca u përshëndet nga, Zëvendësrektorja e Universitetit, Prof. as. Dr. Elvira Fetahu, e cila diskutoi mbi nevojën dhe rëndësinë e kërkimit shkencor në Universitetin e Elbasanit dhe zbatimit të projekteve të lidhura me kërkimin, me financim kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të ftuar në seancën plenare për të përshëndetur punimet e kësaj konference ishin Dr. Robert Gajda, Komisioneri për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe Znj. Mirela Muca, Drejtor i përgjithëm i AKKSHI në shprehje të bashkëpunimit të Fakultetit tone me institucionet që ato përfaqësojnë.

Prof. Giovanni Luchena nga Universiteti i Barit “Aldo Moro”, Itali mbajti ligjëratën kryesore në funksion të tematikës së konferencës.

Në konferencën e këtij viti, krahas paneleve tematike, u organizuan dy panele të veçanta për të prezantuar dhe diskutuar kërkimet e realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare në të cilat Fakulteti Ekonomik është partner, ndër të cilat projekti EIT HEI\_ HEI4Future, Projekti Erasmus+ CBHE\_EntrAL, Projekti Jean-Monet, etj. si dhe projekte të financuar nga AKKSHI në bashkëpunim me Universitetin tone.



**UNIVERSITY OF ELBASAN  
"ALEKSANDËR XHUVANI"  
FACULTY OF ECONOMY**



**11<sup>th</sup>**

**INTERNATIONAL  
SCIENTIFIC CONFERENCE  
RECENT CHALLENGES IN  
ENTREPRENEURSHIP  
INNOVATION AND LEGAL  
FRAMEWORK**

**NOVEMBER 18, 2023**






[www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)







